



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

I	Data	18.12.23	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	09	Shtojcë	370/01-32022-1

KONTRATA PËR FURNIZIME

Komuna e Kaçanikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga **Shefket Koxha – Menaxher i prokurimit**; në njërin anë dhe

"PRO MEDICAL" Shpk nga Ferizaj (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar ngai i autorizuari **Andi Bala me Nr. Personal 1172682096** ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizim me Mjete mjeksore për QKMF-në

me numër Identifikues : **652-23-12817-1-3-6**

KA652/23/110/136

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të **Furnizim me Mjete mjeksore për QKMF-në**

1.2 Kontrata hynë në fuqi **18.12.2023 deri më 23.12.2023**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **5 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi **Komuna Kaçanik**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **7,229.00 €;**
me fjalë (Shtatë mijë e dyqind e nëntë euro)

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro në llogarin Bankare).

Autoriteti Kontraktues do të paguaj OE dhe atë pas pranimit të punëve nga na e menagjerit të projektit si dhe komisionit për pranim të punëve

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *punëve*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve] [punëve]* *[shërbimeve]* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo

nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën komunale në Kaçanik* në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] ² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Andi Bala	Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	I autorizuar	Pozita:	Menagjer i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	18.12.2023	Data:	18.11.2023
Vula:		Vula:	

QKMF -Kaçanik

Kërkes për mjete mjeksore

15.11.2023

Nr.	Emertimi I Artikullit	Specifikat teknike	Njësia	Sasia	ÇMIMI	ÇMIMI TOTAL
1	Pulsoksimeter	Matjet e parametrave: SpO2 + Matjen e pulsit + NIBP Dimensionet: 116*89*46mm Peshë: 65g (përfshirë baterite) Modaliteti i shfaqjes: 4 menyra të shfaqjes Kapaciteti i matjes së pulsit: 30 - 250BPM Konsumi i energjisë: 2*1.5V(AAA) bateri alkaline	Copë	90	11.50 €	1,035.00 €
2	Aparat për pastrim të veshit, me rrymë	Konsumi i energjisë: 240V, 50/60Hz Presioni statik: 0.25 - 3 bar max. Koha e punës: 2-3 min, për 500cc Përdorimi i vazhdueshëm: 5 min Rezervuari: 500ml Presioni: 860 - 1060 hpa	Copë	5	379.00 €	1,895.00 €
3	Aparat për matjen e tensionit, Tensiometer me stetoskop	Sfigmomanometer aneroid Manometer celik 0-300mmhg +/-3mmhg Manzhete dhe umaze metalike Stetoskop	Copë	100	12.00 €	1,200.00 €
4	Gershëre	Materiali: metal	Copë	30	3.00 €	90.00 €

5	Peana kirurgjik	Materiali: metal	Copë	30	4.00 €	120.00 €
5	Otoskop per kontrolle te veshit	Otoskop	Copë	10	44.00 €	440.00 €
6	Karrik Gjinekologjike me tre motora	Specifikacionet teknike - Tabeta e ekzaminimit gjinekologjik elektrik - Funkcionon elektrikiqshi nëpërmjet tre aktivizuesve linearë - Rregullimi elektrik i mbështetës - Rregullimi elektrik i lartësisë - Rregullimi elektrik Trendelenburg - E montuar në rrota rrotulluese 125 mm me frenë diagonale - Platformë dy sheku me 3 seksione - Seksioni i këmbës është i lëvizshëm - Dyshek shtunë me densitet të lartë me tapiceri lëkure artificiale të cilësisë së lartë - Mbulesa plastike ABS për shasinë e poshtme dhe për platformën e sediljes për më mirë - procedurat e dezinfektimit dhe pastirimit - Konstruksion i fortë metalik i salduar me shtresë pluhuri epoksid - Mbatëse rrotull letrë në pjesën e fundit të kokës - Doreza kapëse të lëvizshme - Mbështetëse gjurish të rregullueshme dhe të lëvizshme nga poluretani - Tas i lëvizshëm prej çeliku inox. - Tërë motora - Kontrolllo me digjiron komantues per levizjet - Përmasat: 650x1460x750-890H	Copë	1	2,449.00 €	2,449.00 €
Totali :						7,229.00 €

Operatori ekonomik duhet te dorezoj edhe katalogun gjata ofertimit

